

# CHALLENGES OF THE HIGHER EDUCATION IN ALBANIAN LANGUAGE IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA

**dr.sc.DashmirIdrizi**

## **Preface**

Since higher education is one of the most important segments of social life, it is reasonable that through a retrospective of events and development of education in the Albanian language to offer the public a real insight on this issue.

Legitimate right to higher education in mother tongue is guaranteed by international acts, however, journey to the practical realization of this right within the public system in RM has been difficult and in this direction within the paper will be added to concrete activities that are undertaken, ranging from civic to formalize higher education in mother tongue.

The thesis contains theoretical explanations for the connection of higher education in Albanian in Macedonia, this paper has considerable theoretical significance and represents a significant contribution to higher education in Albanian in Macedonia, given the fact that here all the activities examined, the circumstances and political environment on the matter that is the subject of research.

Practical importance of this research lies in the fact that the results achieved, will serve the wider public, for more concrete knowledge about the situation that has to do with the development of formal and informal activities in realizing the right to higher education in Albanian in Macedonia.

Initially, in the first chapter are added to international standards as the basis for the realization of this right, starting from United Nations activities, those of the Council of Europe and European Union.

In the second chapter is devoted to a historic importance to the development of higher education in general in Macedonia, but also examined the position of Albanians in this system. The third chapter deals with education in Albanian, the process of legalization and then challenges it faces today.

In the last chapter were conducted interviews with eminent persons and was conducted the survey with university students in Albanian.

## **Conclusion**

Objective of this thesis focuses on Standards in high Education RM, starting with the opening of St. Cyril and Methodius University in Skopje, to continue on after the civil initiative for the establishment of TU, until today. Given the fact that the UN General Conference Educational, Scientific and Cultural Rights held in Paris from 14 November to 15 December 1960 adopted the Convention against Discrimination in Education, was unjust that Albanians were denied education in native.

Considering that discrimination in education is a violation of human rights and respecting the diversity of national systems of education, not only has a duty to condemn any form of discrimination in education, but also to promote equality of opportunity and treatment for all the peoples who live in a country, to have the right to education at all levels no matter the country where they live. Unfortunately, Macedonia despite of its declaration as an independent state in 1991 was accepted as a member of the UN and also was a signatory of this convention, but it unfortunately did not follow this convention in practice. We can say that it has started its implementation in 2000 when he brought a decision on the establishment of private universities, where the Albanians were able to attend classes in Albanian (the University's founding, and later in 2004 when he brought Law to formalize the University of Tetovo).

Citizen Initiative also affected the education law change by Parliament of RM, that minority peoples have the right of the opening of private universities, which brought the opening of the Southeast European University, for so am concentrating on in Chapter III The behavior of law involving the opening of universities in Albanian, mainly the establishment of the TU-Tetovo University and University of University of South-East and their functioning, their membership in the big family of European universities which simultaneously are also members of the Bologna Process.

From discrimination mentioned above had to be incurred by a citizens' initiative University that would meet the needs of Albanians to study in Albanian. It happened on June 4, 1994 when the Assembly was held in Tetovo ranking university intellectuals from Macedonia, where he made the decision to establish the University in Albanian in Macedonia, with headquarters in Tetovo. But unfortunately, although this institution was opened with the support of three Albanian municipalities and support the Albanian political factor of the time, almost acted outside the system to its formalization in 2004.

Meanwhile on the other state to lose weight TU step Pedagogical Faculty in Skopje in 1995, while amending the law on education in 2000 minority peoples living in Macedonia with over 20% of the enable education

in their mother tongue after that was opened SEEU who legally chose the problem of education of Albanians. On the other hand outside the UT system has operated until 2004. Thankfully by the intellectuals persistence teaching staff, students and the Albanian political factor in Macedonia, XXI century found the Albanians of Macedonia to two higher education institutions in the Albanian language and the other a private one state. If we look at statistics will notice a significant difference in 1992/93, a total of 26.299 students in Macedonia, Albanians were represented 2.23% of total enrollment in universities. This is different to the situation of the year 2004/2005, where students from 61.556 Albanians represented by 15:50% of the total number of students. And do not talk recently where almost 50 percent of graduates continue their studies

To meet the possible shortcomings of this topic to master that inadvertently may exist in the fourth chapter I have interviews with prominent figures of higher education who have been directly involved in solving the problem of higher education in Macedonia. They conclude that the opening of universities in the Albanian language has been undeniable, and seek the state to fund them to have better conditions for the normal development of the educational process.

Also in the fourth chapter I have developed the survey with students of both universities involving 634 students from two universities in Tetovo (SUT and University).I reached the conclusion that education in the Albanian language has been irreplaceable as the possibility of success reached to no doubt that it is easier. They demand that the observance of the Bologna process and are for him to improve conditions for the normal development of the educational process, establishment of University Libraries and so on.

But what should definitely be taken apart and measures for the normal development of the teaching process is the removal of policy from institutions of higher education, so require students.

Survey that I conducted with students at SUT and University, they complain about lack of cabinets to professional, lack of library instruction, student halls or sports terrains where they can spend their free time, etc..

I would have finished with it you first need to be reformed: the Ministry of Education of the Republic of Macedonia, Curriculum, teachers, and then these reforms be implemented in practice. Unfortunately, attempts to reform government to start from non-students or students from the educational system and curricula.

## **SRUKTURIMI I TEMËS**

*Hyrje* .....3

**ARSIMI SIPËROR NË MAQEDONI: MUNDËSITË REALE PËR ARSIMIM SIPËROR NË GJUHËN SHQIPE**

**1.FILLET E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT SIPËROR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**.....4

1.1 Shkolla e Lartë Pedagogjike.....	5
1.2 Pozita e shqiptarëve në procesin e arsimit të lartë në Maqedoni.....	6
1.3 POLITIKA E KUOTAVE:KYÇJA E STUDENTËVE SHQIPTAR NË PROCESIN ARSIMOR NË GJUHËN MAQEDONASE	
1.3.1 Akademia Pedagogjike – Shkup .....	9
1.3.2 Themelimi i Fakultetit Pedagogjik.....	12

## **PROCESI I LEGALIZIMIT TË ARSIMIT SIPËROR NË GJUHËN SHQIPE**

2.1. Iniciativa qytetare për themelimin e institucioneve për arsim të lartë .....	13
2.2. Rasti i UT-së “ Universiteti i Tetovës” .....	14
2.3. Rasti i ” Universiteti i Evropës Juglindore” ( UEJL-së).....	16
2.4.Themelimi dhe funksionimi i “Universitetit të Tetovës “(UT-së).....	18
2.5. Sfidat me të cilat ballafaqohet arsimit sipëror në RM.....	20
Rekomandime.....	21
Literature .....	22

## **H Y R J E**

Meqenëse arsimit sipëror është një nga segmentet më të rëndësishme të jetës shoqërore, është e arsyeshme që përmes një retrospektive të ngjarjeve dhe zhvillimit të arsimit në gjuhën shqipe t’i ofrojmë publikut një pasqyrë reale mbi këtë çështje .

E drejta legjitime për arsimin sipëror në gjuhën amtare është e garantuar me akte ndërkombëtare, megjithatë rrugëtimi deri në realizimin praktik të kësaj të drejte brenda sistemit publik në RM ishte i vështirë dhe në këtë drejtim brenda punimit do të shtohen edhe aktivitetet konkrete që janë ndërmarrë, duke filluar që nga iniciativa qytetare deri në zyrtarizimin e arsimit sipëror në gjuhën amtare.

Fillimisht, rëndësi i përkushtohet një historiku të zhvillimit të arsimit sipëror në përgjithësi në RM, por shqyrtohet edhe pozita e shqiptarëve në këtë sistem. Cili ishte angazhimi i kuadrit shqiptar në institucionet e larta arsimore, koha kur përfaqësimi i studentëve shqiptar filloi të lulëzojë. Por, fatkeqësisht ky lulëzim zgjati shumë pak, pasi pas demonstratave të vitit 1981 në Prishtinë dhe më gjerë filloi dal ngadalë përjashtimi i mësimitdhënësve që më vonë kjo të rezultojë edhe me mbylljen e të gjitha drejttimeve ku mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe.

Më tej në këtë temë shtjellojmë atë që ka të bëjë me fillimin e hapjes së institucioneve të larta arsimore siç janë UT-ja pastaj UEJL-ja ku shqiptarëve për herë të parë ne vendin ku

jetojnë pra, në Maqedoni iu dha e drejta për arsimim në gjuhën shqipe, **procesi i legalizimit dhe më pas sfidat me të cilat ballafaqohet ai në ditët e sotme.**

Edhe pse, rruga deri mundësia për të studiuar në gjuhën shqipe dhe në Universitetet shqiptare nuk ishte e shtruar me lule. Për këtë edhe do të mundohemi që këtë teme ta shtjellojmë në vazhdim.

## **ARSIMI SIPËROR NË MAQEDONI: MUNDËSITË REALE PËR ARSIMIM SIPËROR NË GJUHËN SHQIPE**

### **1.FILLET E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT SIPËROR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

Menjëherë pas çlirimit të vendit nga forcat okupuese fashiste organet shtetërore të Maqedonisë në vitin 1945 lëshuan urdhër për nismën e hapjes së degëve të fakulteteve të para të Universitetit të R.S të Maqedonisë me qendër në Shkup, më 24 prill 1949 u formua Kuvendi i parë i Universitetit, si rezultat i zbatimit të Ligjit Nr. 5 të datës 29 janar të vitit 1949, të miratuar nga Kuvendi i Republikës Popullore të Maqedonisë. Në këtë Kuvend u dha edhe emërtimi i Universitetit “Cirili dhe Metodij”, ndërsa si çerdhe e parë e këtij institucioni arsimor-shkencor ishte Fakulteti Filozofik dhe institucionet përkatëse përcjellëse, si dhe institutet e para me laboratorë dhe biblioteka përcjellëse.

Në prill të vitit 1946 u bë konstituimi i Komisionit amë në përbërje prej pesë anëtarëve me detyrë të organizojë fillimin e punës së institucioneve të para të Universitetit. Në mungesë të kuadrit arsimor-shkencor u veçua si detyrë prioritare të gjurmohen kuadro nga qendra universitare jashtë Republikës,<sup>1</sup> brenda ish Federatës Jugosllave.

Më 29 nëntor 1946 solemnisht u shpall i hapur Fakulteti Filozofik, me seli në Shkup.

---

<sup>1</sup> Për këtë qëllim u themelua Këshilli qendror në përbërje prej tre anëtarëve, të tri qendrave më të hershme universitare: dr. FranTuqan nga Univerisiteti i Zagrebit dhe dr. Anton Meliq nga Universiteti i Lubjanës.

Në funksion edhe të këshillit recensues, ky këshill në nëntor të vitit 1946 bëri zgjedhjen e tetë arsimtarëve të parë me thirrje të profesorit ordinar: BorisKitanov, dr. HihalPetrushevski, dr. DragosllavMitrinoviq, dr. FranPetre, dr. HaralmpiePolenakoviq, dr. VasoTomanoviq, dr. AtanasijeUrosheviq dhe dr. GjorgjiShoptrajnov.

Më 16 dhjetor të vitit 1946 filluan edhe ligjëratat e para në degët e posathemeluara: gjuha maqedonase, letërsia jugosllave, historia, historia e artit, filozofia, pedagogjia, filologjia romane, filologjia klasike, matematikë, fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi me etnologji.

Një vit më vonë, më 1947 filloi me punë Fakulteti i Mjekësisë dhe ai i Bujqësisë – Pylltarisë.

Mëvetësimi, degëzimi dhe zhvillimi i degëve evoluoi në mënyrë suksesive në intervale të mëvonshme që në vitin jubilar 1988, Universiteti “Ciril dhe Metodij” në Shkup të numërojë 28 fakultete, 6 shkolla të larta dhe 8 institute shkencore të pavarura me 28.205 studentë të regjistruar.<sup>2</sup>

Në vitin akademik 1951-52 pranë Fakultetit Filozofik për vizita eventuale të studentëve (eventual) me përkatësi shqiptare, ishte hapur dega e Lektorit në gjuhën shqipe.

Afër një dekadë më vonë, në vitin 1959-60 lektorati u rrit në seminar të gjuhës shqipe, ku kjo gjuhë mund të ndiqej si lëndë plotësuese nën “C” për studentë eventualisht të interesuar shqiptarë, e posaçërisht ato që do të studionin në degën e filologjisë romane.

Pas shtatë viteve, më 1967, seminari e fitoi edhe një shkallë duke kaluar gjuha shqipe në grupin “B” si lëndë e dytë e studentëve shqiptarë të degëve humanitare – gjuhësore.

Pasi kaluan dy dekada e gjysmë nga themelimi i Universitetit të Shkupit, në vitin 1971-72 u themelua grupi i gjuhës dhe letërsisë shqipe, por në kuadër të degës së gjuhëve jugosllave e ballkanike deri në vitin 1973, kur ajo u mëvetësua si degë e veçantë.<sup>3</sup>

## 1.1 Shkolla e Lartë Pedagogjike

Shkolla e lartë pedagogjike, si institucion për krijimin e kuadrit mësimor për arsimin fillor, është formuar me DEKRETIN e kryetarit të shtetit Nr. 7852 të datës 17.09.1947, ndërsa nga 1961 vazhdoi të funksionojnë si Akademi pedagogjike.

Në bazë të nenit 4 mund të konstatohet se veprimtaria themelore e kësaj shkolle ka qenë të krijojë arsimtar lëndor për shkollat tetëvjeçare për klasat e ulëta të gjimnazeve, sipas nevojave të sistemit të atëhershëm shkollor.

Shkolla e Lartë Pedagogjike ka qenë e formuar si institucion i mëvetësishëm në kuadër të Ministrisë së Arsimit të RPM-së, e cila bënte edhe mbikëqyrjen mbi punën e shkollës, gjithashtu me këtë dekret (neni 2) financimi ka qenë i rregulluar të jetë nga Ministria e Arsimit.

Me rëndësi të madhe historike-pedagogjike është neni 7 ku thuhet: “Planet dhe programet mësimore i sjell Ministria e Arsimit e Republikës Popullore të Maqedonisë, pas miratimit nga ana e Komitetit për shkolla dhe shkencë në kuadër të Qeverisë së RFPJ-së”.

---

<sup>2</sup>Që nga themelimi e deri në vitin akademik 1987-88 në Universitetin “Cirili dhe Metodij” të Shkupit u diplomuan gjithsej 78.864 studentë të të gjitha profileve. Në po këtë vit Universiteti numëron 1.709 punëtorë arsimor-shkencor.

<sup>3</sup>Është në interes të këtij kërkimi të theksohet se që nga themelimi i lektoratit, 1951-52 e deri në themelimin e degës 1971-72, plot 20 vjet gjuhën shqipe në Fakultetin Filozofik e ka drejtuar vetëm një lektor, dr. PetroJanura. Me themelimin e degës u inkuadrua në punë mësimore-shkencore dhe dr. RemziNesimi, prof.Xhevat Gega dhe bashkëpunëtorë nga Universiteti i Prishtinës, dr. LatifMulaku dhe dr. ShefqetPllana.

Kohëzgjatja e shkollimit gjithashtu është e përcaktuar me Dekret: "Shkollimi në shkollën e lartë Pedagogjike zgjatë një vit për dëgjuesit e rregullt, kurse dy vite për ata me korrespondencë"<sup>4</sup>.

Me këtë Dekret ishin dhënë edhe kahet themelore për hapjen dhe funksionimin e këtij institucioni.

Në hap me kalimin e Shkollës së Lartë Pedagogjike në Akademi Pedagogjike, 1961-62 u themelua edhe dega e grupit klasor, nevojë kjo e imponuar për shkak të suprimimit të shkollës normale në gjuhën maqedonase, e dispersuar me Akademi të re Pedagogjike për kuadro të mësimit klasor në gjuhën maqedonase në Manastir dhe në Shtip. Po këtë vit u hap edhe grupi për arsimimin politeknik, e një vit më vonë edhe grupi fizikë-kimi.

Siç shihet, me një ritëm të intensifikuar AP i mbuloi të gjitha disiplinat mësimore fillore, por vetëm në gjuhën maqedonase, me përjashtim të pakapërcyeshëm të grupit të gjuhës shqipe. Për të përcjellë me sy studiues analitik ecurinë e Universitetit të Shkupit, duke respektuar edhe fatin e pozitës së shqiptarëve në Maqedoni, mund të konsiderohet si kthesë fatlume historike viti akademik 1965-66, kur filloi të marrë frymë edhe gjuha shqipe në arsimimin e lartë për studentët e përkatësisë shqiptare, me atë se në këtë vit u organizua mësimi paralel dhe biologji-kimi, prej vitit 1969-70 edhe grupi matematikë-fizikë, fizikë-kimi dhe grupi klasor.

Grupet përjetuan sendërtime, rikonstruime dhe oscilime që i diktonte koha, e më pastaj u standardizuan gjithsej 14 grupe, nga të cilat 12 me mësim në gjuhën maqedonase, 5 grupe mësimore dhe mësim paralel në gjuhën shqipe, grupi i gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe ai gjuhës turke.

Në interes të këtij studimi me këtë edhe në interes të përgjithshëm shoqëror të citojmë një fragment nga fjala e një përvjetori të AP-së ku, ndër të tjera thuhet: "Në shtatë vitet e fundit, prej vitit 1965 e më vonë, me aplikimin e mësimit në gjuhën mësimore shqipe në disiplina të arsimimit të përgjithshëm (mendohet në pedagogji, psikologji, sociologji dhe MPP) për studentët e të gjitha grupeve, si edhe në studime të veçanta të më shumë grupeve mësimore rritet dukshëm numri i studentëve të përkatësisë shqiptare dhe kështu, Akademia Pedagogjike "Klimenti i Ohrit" bëhet institucion arsimor më masiv për përgatitjen e kuadrit të arsimimit të kombësisë shqiptare dhe turke në Republikë"<sup>5</sup>.

## 1.2 Pozita e shqiptarëve në procesin e arsimit të lartë në Maqedoni

Pasi filloi të zgjerohet prezenca e elementit shqiptar në AP, ndryshoi edhe raporti i marrëdhënieve ndërnjerëzore e ndërnacionale brenda institucionit. U krijua një klimë sado modeste, por në dobi reciproke për zgjidhjen e problemeve kadrovike në Akademi dhe jashtë, në shkollat fillore e më gjerë që e prisnin ndihmën e AP-së në të tri gjuhët mësimore: maqedonase, shqipe dhe turke. Po këtë atmosferë ndërkolegiale e vërejmë edhe në raportin jubilar 1947-1977, ku ndër të tjera ndihet tendenca e ndërlihdjes së interesit të përbashkët të punësuarve për t'i bërë

---

<sup>4</sup>Si dëgjues me korrespondencë llogariten ata të cilët që janë në si mësues ose si arsimtar"(neni 3).

<sup>5</sup>XhonDjui, Obrazovanie i demokratija (përkthim), Cetinje 1966, TahirZajazi (Themelimi dhe zhvillimi i Akademisë Pedagogjike "Klementi i Ohrit" në Shkup, faqe 76

ballë strategjisë së inicuar të asaj kohe për reformimin e Universitetit. Në fakt, Akademia zgjidhjen e problemit të reformimit të vet e ndërlihdh me respektimin e prezencës së elementit shqiptar në të, duke e përdorur me të drejtë argumentin se ky institucion është i vetmi në Republikë që i është rrekur përmbushjes së kërkesave aq të mëdha të kuadrove edhe në gjuhën shqipe.

Në frymë të këtyre qëndrimeve në projektin “Zhvillimi perspektiv i Akademisë Pedagogjike” ndër të tjera thuhet “... kështu i integruar institucioni i arsimit superior duhet të jetë Fakultet Pedagogjik ose qendër universitare... që do të organizojë veprimtari mësimore të arsimit të shkallës së parë, arsimimit të shkallës së dytë dhe të shkallës së tretë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe”<sup>6</sup>.

Asaj kohe AP në mesin e 92 arsimtarëve sa ishin të inkuadruar vepronin edhe 24 arsimtarë të kualifikuar të përkatësisë shqiptare që dinin të shërbehen me numra dhe fakte për të dëshmuar nevojën e pashmangshme të zhvillimit perspektiv e normativ të barabartë të shkollimit edhe të kësaj përkatësie (formalisht) të barabartë në Republikë, në Akademi e më gjerë.

Në valët e këtyre trendeve zhvilluese të asaj kohe u punuan edhe disa projekte për hapjen e mësimimit paralel në gjuhën shqipe edhe në disa degë të arsimimit superior të fakulteteve të tjera të Universitetit, që në fakt nuk panë dritë (dega e drejtësisë dhe ekonomisë).

E gjithë kjo përbrenda Akademisë krijoi një klimë të mbështetur se nuk ka shteg pa u përfillur edhe elementi shqiptar në arsimin sipëror në Universitetin e Shkupit.

Ndërkaq, fuqive burokrate e retrogrande të asaj kohe nuk u pëlqente ky trend, zhvillimi dhe kahe të drejtuara në kërkimin e baraspeshës së arsimit edhe të shqiptarëve në këtë Republikë të përbashkët. Kështu mendonin njerëzit pa përgjegjësi e ndërgjegje morale të cilët nuk kuptonin dhe nuk donin të vepronin sipas fjalës së urtë latine: “Bëje për njeriun atë që dëshiron të jetë edhe për ty” ose të paktën urtësisë tjetër latine që e përforcon edhe interesin tënd: “Miqësia ndërmjet të barabartëve është e fortë”. Megjithatë, klima e përgjithshme politike e asaj kohe nuk u jepte guxim publik për një gjë të këtillë.

Prandaj, edhe atë e mbyllnin përmes kanaleve të pazëshme të “nëntokës” për t’i prerë rrënjët e frymëmarrjes progresive demokratike të arsimimit të shqiptarëve në Maqedoni. Ata kishin bashkëpunëtorë besnik të helmuar përbrenda edhe në Akademi, por ende të paguximshëm, të patrimëruar dhe të pamobilizuar për t’i vënë në tryezë aspiratat famëkëqija antishqiptare. Në të kundërtën nga kjo, një numër i të punësuarve maqedonas ishin të bindur se rruga zhvillimore e Akademisë në qendër universitare për kuadro arsimore të të gjitha profileve e niveleve është direkt e kushtëzuar nga qenia e elementit shqiptar në të.

Prandaj, edhe për interesat thjesht ekzistenciale personale i jepnin përkrahje të plotë zhvillimit të Akademisë në qendër universitare edhe me elementin shqiptar në të. Në mesin e tyre natyrisht ka pasur edhe profesorë të sinqertë.

Këto oscilime baticash e zbaticash ideore vazhduan deri në vitin famëkeq historik e të paharruar të popullit shqiptar, 1981 kur u shpall kontrarevolucioni i shqiptarëve ndaj Jugosllavisë. Ky ishte një vit i një kthese të mbrapshtë të strategjisë së thyerjes së etikës njerëzore me tendenca për ta mposhtur elementin shqiptar dhe për ta eliminuar atë nga të gjitha rrjedhat e jetës ekonomike, intelektuale e politike. Filloi fushatë e madhe e pamoralshme anti-humane, duke i kërkuar rrënjët e të gjitha kanaleve të funksionimit të kulturës, të ekonomisë dhe të politikës edhe ashtu të molisur shqiptare në Maqedoni.

---

<sup>6</sup>ZajaziT. Jehona, nr.1-2/1999 f-77



Në valët e këtij vërshimi uragan nuk mundi të shmangej edhe AP-ja. Si hap i parë filloi faza e shpalljes së hapur frontale kundër reflektimeve të ngjyrës shqiptare në Akademinë Pedagogjike, siç ishte administrimi edhe në gjuhën maqedonase, plotësimi i indeksit të studentëve, notimi, sjellja jo e drejtë ndaj kolegëve shqiptar etj.

Nga ana tjetër, kuadri arsimor shqiptar i Akademisë me atë përvojë e pjekuri veprimi dhe me atë numër studentësh shqiptarë, kishin zënë themele që nuk ishin për t'i nënçmuar. Duke e pasur parasysh këtë fakt politika famëkeqe bolshevike-komuniste e Maqedonisë e përforcoi koalicionin me qendrat e tjera simotra të Beogradit dhe hartoi program me strategji perfide për çrrënjosje kategorike të arsimimit dhe të çdo sferë tjetër me përbajtje shqiptare. Si çerdhe e prodhimit të kuadrove të arsimimit shqiptar, në front të parë ishte AP-ja. Autorët e këtij programi ishin të vetëdijshëm se shkapërderdhja e Akademisë e demonton kanalën e ushqimit të shkollave filllore, pjesërisht edhe të mesme (studentë të diplomuar të AP-së, zakonisht vazhdonin studimet në fakultete përkatëse) me kuadro në Maqedoni.

Si fazë e parë, e projektit të zhvillimit perspektiv të Akademisë iu kundërvu projekti kundërthënës me të, sipas të cilit parashihej reformimi i Universitetit me pretekst të reduktohen institucionet paralele në emër të ekonomizimit të arsimit superior. Si alibi u “zbulua” arsyeja se grupet e AP-së veprojnë si degë paralele me ato të fakulteteve të Universitetit që përgatisnin kuadro arsimore të nivelit sipëror. Në hap me këtë u intensifikuan akuzat ndaj Akademisë duke quajtur atë “çerdhe” të “nacionalizmit”, e të “separatizmit” etj.

Si hap i dytë i këtij programi doli në shesh strategjia e mënyrës së eliminimit, të kuadrit shqiptar në Akademi. U zgjodhën disa metoda johumane të veprimit:

- a) Arsimtarët që janë anëtarë të LKJ-së të akuzohen se kanë rënë në kundërshtim me Platformën e LKJ-së, të përjashtohen nga rradhët e saj dhe me automatizëm të largohen nga vendi i punës.
- b) Arsimtarët që kishin fat të jenë të moshuar, dhunshëm të përcillen në pension të parakohshëm sipas parimit të kombinimit të stazhit të punës.
- c) Si variant i fundit, të aplikohet principi i “tepricës teknologjike”.

Lansoheshin fakte të paqena, të fabrikuara me kohëzgjatje maltretuese e fyese, që të arrihej edhe efekti i shkatërrimit.

Nga viti akademik 1983-84 filloi shkapërderdhja e grupeve mësimore, e deri në tetor të vitit 1987 mbeti vetëm grupi klasor me matematikë-fizikë me mësim paralel në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Më 08.10.1987 Këshilli Arsimor i Akademisë me Dekret të nënshkruar nga ministri i Arsimit të asaj kohe, u morr vendim që të jetësohet neni famëkeq (11-të) i Ligjit të Arsimit të Orientuar të Maqedonisë, i cili parasheh që mësimi në institucione të Universitetit të zhvillohet vetëm në gjuhën maqedonase, kuptohet që më parë strategji e përgatitur e më pastaj të lansohet në rastin e volitshëm.<sup>7</sup>

Me këtë përfundimisht iu dha fund mësimit në gjuhën shqipe në AP të aplikuar në intervalin 1965 e deri më 1987.

---

<sup>7</sup>Zajazi T. Jehona, nr.1-2/1999 f-81

## **1.3 POLITIKA E KUOTAVE:KYÇJA E STUDENTËVE SHQIPTAR NË PROCESIN ARSIMOR NË GJUHËN MAQEDONASE**

### **1.3.1 Akademia Pedagogjike – Shkup**

Sipas të dhënave statistikore zyrtare<sup>8</sup> treguesit e gjetur kuantitativ dëshmojnë se ky institucion i mirënjohur në Universitetin e Shkupit, në intervalin e punës 30-vjeçare, përkatësisht 1947-1977 ka absorbuar numër më të lartë të studentëve në Universitetin e Shkupit. Nga gjeneza në tri dekadat e para në të janë regjistruar gjithsej 24.107 studentë. Kuptohet, kanë diktuar nevojat e larta për kuadër arsimor në shkollat fillore.

Për kualifikimin e kuadrove me korrespondencë ajo ndërkohë organizoi edhe qendra të përkohshme studimesh në Kumanovë, Kavadar, Prilep, Leskovac, Pançevë, Tetovë dhe Gostivar.

Pasi kaluan 19 vite të veprimtarisë aktive të këtij institucioni, për herë të parë prej vitit akademik 1965-66 u hapën dyert edhe për studentët shqiptar duke e vënë në jetë mësimin me paralele edhe në gjuhën shqipe, u hapën pesë grupe mësimore (pa e numëruar grupin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe) me mësim në gjuhën amtare. Gjithashtu u mundësua të ligjërohet në gjuhën shqipe edhe në disiplinat me karakter të arsimit të përgjithshëm (pedagogji, psikologji, sociologji dhe mbrojtje).

---

<sup>8</sup>“ Rruga e zhvillimit dhe perspektiva e saj”, (botimi jubilar në dy gjuhë paralele e Akademisë Pedagogjike


“KlimentOhridski”)– Shkup, 1977.

Sipas treguesve numerikë në intervalin shtatëvjeçar (1965-1972) të punës së grupeve mësimore në gjuhën shqipe në AP dukshëm ndryshoi struktura nacionale e përbërjes së studentëve, ku nga numri i përgjithshëm i tyre 18% janë të përkatësisë shqiptare në vitin jubilar 1972, AP numëron 583 studentë të përkatësisë shqiptare, 531 maqedonas, 126 serb, 22 turq, 20 bullgarë, 11 malazez, 9 kroatë dhe 24 të tjerë.<sup>9</sup>

Pesë vite më vonë, 1972-1977 Akademia shënoi rritje të papritur të studentëve të përkatësisë shqiptare, me çka përqindja e vitit 1972 kaloi prej 18 % në 33% .

Edhe pse përqindjet e shprehura, 18 dhe 33 lënë përshtypjen se përfshirja e studentëve të popullsisë shqiptare në këtë institucion është e masivizuar, treguesit numerikë dëshmojnë se megjithatë prezenca e elementit shqiptar edhe në Akademinë Pedagogjike “Klementi i Ohrit” të Shkupit nuk e përmbush as edhe minimumin e domosdoshëm për t’i thënë barabarësi nacionale në arsim të lartë.

Diagrami nr. 1 tregues të përfshirjes së studentëve sipas përkatësisë nacionale (1947-1972)<sup>10</sup>



Legjenda: 1. Maqedonas 62 %                      5. Turq 2 %  
 2. Shqiptar 18 %                                      6. Malazias 1,5 %  
 3. Serbë 12 %                                      7. Të tjerë 1 %  
 4. Bullgarë 3,5 %

Sipas të dhënave statistikore oficiale nga themelimi e deri në vitin 1977 në të gjitha degët mësimore të Akademisë me mësim në gjuhën maqedonase dhe shqipe u diplomuan gjithsej 6.161 arsimtarë maqedonas (e të tjerë) dhe 986 arsimtar të përkatësisë shqiptare, ose në numër relativ 13,79 %<sup>11</sup>

Nr.	Dega	Nr. i përgj. i të diplomuarve	Nr. i të diplom. shqiptar	%
1.	Gjuhë maqedonase	259	-	0,00
2.	Gjuhë dhe letërsi shqipe	44	44	100,00
3.	Histori e letërsi të popujve 2078	2063	15	0,72

<sup>9</sup>Shkolla e Lartë Pedagogjike , Akademi Pedagogjike, Fakultet Pedagogjik (1947-1961-1996-2007), Shkup 2007  
 Universiteti “Sh. Kirili dhe Metodi” Fakulteti Pedagogjik “Sh.KlimentOhridski” – Shkup, “60 Vite”, faqe 14

<sup>10</sup>Po aty ” Fakulteti Pedagogjik “Sh.KlimentOhridski” – Shkup, “60 Vite”, Zajazi T. Jehona, faqe. 86

<sup>11</sup>Akademia Pedagogjike “KlimentOhridski” (botim në dy gjuhë paralele: maqedonisht- shqip), botim jubilar, Shkup 1972, f.20

4.	Dega e slavistikës	179	-	0,00
5.	Filologjia romane	457	13	2.84
6.	Gjuhë dhe letërsi gjermane	126	1	0,79
7.	Gjuhë dhe letërsi angleze	356	2	0,56
8.	Dega e filozofisë	212	13	6.13
9.	Dega e pedagogjisë	805	33	4.09
10.	Dega e historisë	868	32	3.68
11.	Historia e artit	33	1	3.03
12.	Filologjia klasike	17	-	0,00
13.	Akademia pedagogjike	7.147	986	13.77
Gjit hës ej	a)Pa gjuhë shqipe dhe AP	5.375	92	1.71
	b)Vetëm pa akademinpedag.	5.419	136	2.50
	c)Gjithsej	12.566	1.122	8.92
Tabela 1.: Numri i studentëve të diplomuar shqiptar dhe përqindja e tyre në Universitetin e Shkupit 1965-1977				

Ndërkaq fuqitë retrograde e shkurtpamëse për perspektivën e gjithmbarshme të qytetërimit të tërë popullatës së Republikës, e rrënuan në mënyrën më brutale e të pamoralshme jo vetëm projektin e zhvillimit perspektiv, por edhe retrospektivën e Akademisë me metoda perfide të diferencimit të kuadrove të përkatësisë shqiptare në Akademi dhe jashtë saj.

Duke filluar nga viti akademik 1983-84 në mënyrë suksesive u suprimuan grupet dhe përfundimisht më 08.10.1987 u ndërpre mësimi në gjuhën shqipe në Akademi.

Prej themelimit të grupeve mësimore paralele me mësim në gjuhën shqipe (1965-66) ndryshoi struktura nacionale e studentëve në Akademi duke e arritur ajo shkallën në 18 %, e vetëm pesë vjet më vonë, më 1977, kaloi në 33% në llogari të studentëve të përkatësisë shqiptare.

I veçojmë tri shkaqe të kësaj rritjeje të intensifikuar:

- a) qenia e elementit shqiptar në status të arsimtarit në AP;
- b) klima momentale e volitshme politike e atij intervali kohor ; dhe
- c) gravitimi i nxënësve që kanë kryer shkolla të mesme, që në atë kohë numëroheshin 39 sish me mësim dhe në gjuhën shqipe në Maqedoni.

Sipas rekapitullimit të numrit të përgjithshëm të studentëve të diplomuar në Universitetin e Shkupit, rezultojnë këto konstatime relevante:

a) Gjatë punës intelektuale 30 vjeçare (1946-1976) të Universitetit, në gjashtë degë të Fakultetit Filologjik dhe në pesë degë të Fakultetit Filozofik, nga gjithsej 5375 studentë të diplomuar, vetëm 92 nga to janë të përkatësisë shqiptare, ose shprehur në numër relativ, në 11 degë të këtyre dy fakulteteve nga numri i përgjithshëm u diplomuan vetëm 1,71 % studentë shqiptarë.

b) Në degën gjuhë dhe letërsi shqipe, nga themelimi i deri në vitin 1976 të Universitetit u diplomuan 44 studentë.

c) Në intervalin 1947-1977 të veprimtarisë së AP-së u diplomuan 7147 studentë maqedonas e të tjerë joshqiptarë dhe 986 studentë shqiptarë në të gjitha grupet mësimore (paralele e joparalele), ose 13,77 % të studentëve të diplomuar në AP i përkasin strukturës së përkatësisë shqiptare.

ç) Gjithsej studentë të diplomuar në dy fakultetet dhe në AP janë 12.566 nga të cilët vetëm 1122 janë shqiptarë ose 8.92 %.<sup>12</sup>

Dhe në fund, nga numri i përgjithshëm i studentëve shqiptarë të diplomuar në Universitetin e Shkupit u takojnë lokaliteteve ish jugosllave të banuara me popullatë shqiptare, dukuri kjo që reflekton vonesën e paarsyeshme të themelimit të Universitetit të Kosovës. Nga kjo që tham më lartë mund të veçojmë se nga numri i përgjithshëm i të diplomuarve shqiptar pjesa më e madhe janë banorë të Maqedonisë ndërsa të tjerët u takojnë Republikës së Kosovës, Preshevës dhe Bujanovcit si dhe shqiptarëve të Malit të Zi, që do të thotë se nga 1078 të diplomuar afërsisht 800 janë shqiptar nga Maqedonia.

Me hapjen e Universitetit të Prishtinës në Prishtinë, nxënës nga Maqedonia iu drejtuan Kosovës për dituri.

### **1.3.2. Themelimi i Fakultetit Pedagogjik**

Në bazë të ligjit që kemi paraqitur më lartë Fakulteti Pedagogjik “Shën Klimenti Ohrit” në Shkup veprimtarinë e tij e bazon në përvojën e pasur pedagogjike nga e kaluara, së pari si shkollë e Lartë Pedagogjike, e pastaj si Akademi Pedagogjike, ku përgatitej kuadri mësimor, si për mësimin klasor ashtu edhe për mësimin lëndor në gjuhën maqedonase, në gjuhën shqipe, dhe në gjuhën turke.

Fakulteti Pedagogjik “Shën Kliment Ohridski” në Shkup u themelua me vendim të Rektoratit të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodij” në Shkup Nr.08-856/3 të datës 1995.

Duke u bazuar në vendimin për miratimin e Elaboratit për edukim të edukatorëve dhe mësuesve klasor dhe në pajtueshmëri me Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës Fizike Nr.12-2247/2, Rektorati i Universitetit në mbledhjen 11-të të mbajtur me 13 .06.1995 solli vendim për themelimin e këtij Fakulteti.<sup>13</sup>

Veprimtaria dhe funksioni themelor i këtij Fakulteti ishte krijimi i kuadrit profesional për nevojat e edukimit parashkollor dhe mësimin klasor në Republikën e Maqedonisë. Nevoja afatgjate për krijimin e kuadrit të tillë që caktuar me Elaboratin për edukimin e edukatorëve dhe mësuesve klasor.

Përveç përgatitjes profesionale dhe pedagogjiko-psikologjike të këtij lloji të kuadrit, me Vendim është caktuar edhe veprimtaria shkencore-hulumtuese e këtij Fakulteti (neni 2).

Sipas akteve ligjore dhe akteve të tjera, në Vendim është theksuar se “Përgatitjet për fillimin e punës së fakultetit si institucion i mëvetësishëm i arsimit të lartë dhe zgjedhja e mësimitdhënësve dhe bashkëpunëtorëve u bë nga komisioni amë i përbërë nga 9 anëtarë nga të

---

<sup>12</sup>Rruga e zhvillimit dhe perspektiva e saj, (Botimi jubilar në dy gjuhë i Akademisë Pedagogjike “Kliment Ohridski”), Shkup 1977, f.95

<sup>13</sup> Po aty, fq.3

cilët 4 janë me thirrje mësimore-shkencore, të formuar nga Universiteti “Shën Kirili dhe Metodij” në Shkup (neni 3).

Me këtë vendim gjithashtu parashihet, hapësira dhe pajisjet. Puna mësimore –hulumtuese e Fakultetit do të zhvillohet me pajisjet dhe në hapësirën e Akademisë Pedagogjike “Shën Kliment Ohridski” në Shkup (neni 4).

Ministria e Arsimit dhe Kulturës Fizike e RM-së me vendimin Nr.12-2742/3 të datës 1.10.1995 dha pajtueshmëri për planet mësimore në këtë Fakultet.

Në pikën 2 të këtij Vendimi theksohet:

“Në Fakultetin Pedagogjik në Shkup, në bazë të planeve mësimore për të cilën jepet pajtueshmëri, do të arsimohen kadro profesional për profilet edukator në institucionet parashkollore dhe mësimdhënës për mësimin klasor prej klasës së parë deri në të katërt të shkollës fillore”. Zbatimi i këtyre planeve filloi të bëhet në vitin akademik 1995/1996.

Në pikën tre të këtij vendimi caktohen edhe gjuhët në të cilët do të zhvillohet mësimi për realizimin e këtyre planeve mësimore:” Mësimi sipas planit mësimor për grupin klasor dhe për edukimin parashkollor do të zhvillohet në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët e nacionaliteteve “.

Hapja e këtij fakulteti në këtë kohë nuk ishte asgjë tjetër përpos një iniciativë e qeveris së asaj kohe të Maqedonisë me qëllim të arsytimit para faktorit ndërkombëtar se ja shteti maqedonas mundëson arsimim në gjuhën shqipe për të rinjtë shqiptar. Me një fjalë kjo ishte një tentim i shtetit për të mos lejuar funksionimin e Universitetit të Tetovës i cili u themelua me iniciativë të Bashkësisë Kulturore Shqiptare.

Financimi i studimeve në këtë Fakultet, gjithashtu theksohet se do të bëhet në pajtueshmëri me aktin e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Fizike për financimin e arsimit të lartë.<sup>14</sup>

## **PROCESI I LEGALIZIMIT TË ARSIMIT SIPËROR NË GJUHËN SHQIPE**

### **2.1 Iniciativa qytetare për themelimin e institucioneve për arsimtë lartë**

Mbyllja e Universitetit të Prishtinës në vitin akademik 1992/93 apo më mirë thënë marrja nën kthetra nga ana e qeverisë serbe të këtij institucioni, ndër të tjerat bëri të pamundur shkollimin edhe të shqiptarëve të Maqedonisë. Ndërkaq në Shkup edhe pse ekzistonte një shkollë e lartë pedagogjike me disa drejtime për mësimdhënës, dhe fakulteti Albanologjik në kuadër të Universitetit të Shkupit, fatkeqësisht shumica e lëndëve zhvilloheshin në gjuhën maqedonase.

---

<sup>14</sup>Ideja për lindjen e këtij fakulteti erdhi si rezultat i themelimit të USHT-së i cili u themelua me përkrahjen e kryetarëve të tre komunave më të mëdha shqiptare Tetovës, Gostivarit dhe Dibrës si dhe nga asociacione të tjera shqiptare në Maqedoni etj. Kryesia e Bashkësisë shqiptare me një qasje analitike i përkushtohet kësaj problematike. Kjo kryesi e BKSH angazhimin e grupit të intelektualëve shqiptarë në komisionin amë e çmon të sinqertë, por të pafrytshëm.

Në anën tjetër studentë maqedonas braktisën ligjëratat dhe amfiteatret e universiteteve maqedone duke kundërshtuar kështu themelimin e Fakultetit Pedagogjik tek i cili mësimin do ta ndiqnin të rrinjtë “shqiptar”. Por padyshim se ky njëherit ishte edhe një atak kundër hapjes së UT-së, në të cilin tani më kishin filluar me ligjërata studentët e këtij institucioni.

Duke pasur parasysh këto rrethana, intelektualët shqiptar kishin filluar aktivitetet për vetorganizim të arsimit sipëror.

Angazhimi për themelimin e institucioneve për arsim sipëror në gjuhën shqipe ishte preokupim i faktorëve politikë dhe subjekteve shoqërore shqiptare në Maqedoni, të cilët kishin vlerësuar se ekziston nevoja reale e popullatës për një gjë të tillë. Kjo gjë argumentohej në faktin se në Republikën e Maqedonisë shkollimin fillor për çdo vit e kryejnë mbi 10 mijë nxënës shqiptarë, prej të cilëve, pas përfshirjes në shkollat e mesme, prej tyre së paku 50 % regjistrohen në universitet, ndërsa kuadri arsimor nga radhët e shqiptarëve i plotëson nevojat elementare.<sup>15</sup>

Ndërsa në anën tjetër pas pavarësimit të RM-së (1991), në Universitetet në gjuhën maqedonase (Shkup dhe Manastir) regjistroheshin përafërsisht 5 mijë studentë për çdo vit.<sup>16</sup>

E gjithë kjo kishte ndikuar që shqiptarët të aktivizohen dhe të ndërmarrin iniciativa më konkrete, madje duke kërkuar edhe ndihmën nga ndërkombëtarët për realizimin e kësaj të drejte.<sup>17</sup>

Sipas regjistrimit të popullatës në vitin 2002, Maqedonia evidenton 2,022,547 banorë.<sup>18</sup> Dy bashkësitë më të mëdha në vend, maqedonasit dhe shqiptarët përbëjnë 89.4% të popullatës në nivel shtetëror. Konkretisht, maqedonasit janë të përfaqësuar me 64.2%, kurse shqiptarët përbëjnë 25.2% të popullatës.

Në aspekt të përfaqësimit të dy grupeve më të mëdha etnike në procesin arsimor, Maqedonasit që përbëjnë 64,2% të popullatës në vend përfaqësohen me 55.7% në arsimin fillor, 72.9% në arsimin e mesëm dhe 79.4% nga të gjitha regjistrimet në arsimin e lartë. Nga ana tjetër, shqiptarët, të cilët janë 25.2% e popullatës në Republikën e Maqedonisë", në arsimin fillor përfaqësohen me 33%, në arsimin e mesëm me 20.7%, kurse në arsimin e lartë me 15.5% nga të gjitha regjistrimet.<sup>19</sup> Këto të dhëna tregojnë që maqedonasit kanë nivel më të lartë të pjesëmarrjes në arsimin e mesëm dhe të lartë, për dallim nga shqiptarët që përfaqësohen më tepër në arsimin fillor.

## 2.2 Rasti i UT-së “ Universiteti i Tetovës”

---

<sup>15</sup> Rilindja 2 mars 2004

<sup>16</sup> Elaborati i UT-së 1994 f. 4

<sup>17</sup> Nismës për realizimin e kësaj ideje humane i prinë në mënyrë të organizuar e të argumentuar kryesisht intelektualët universitarë. Pas disa kontaktesh e bisedash me një numër intelektualësh të këtij rangi për nevojën e domosdoshme të një Universiteti me mësim në gjuhën shqipe në Maqedoni, më 14 maj 1994 u mbajt në Tetovë mbledhja e këshillit nismëtar nga profesorët: dr. Murtezan Ismaili, Dr. Rahmi Tuda, Dr. Fadil Suljemani dhe Dr. Ali Vishko, të cilët shqyrtuan rrethanat, mundësitë dhe nevojën për themelimin e këtij Universiteti.

<sup>18</sup> Enti shtetëror statistikor, ” Regjistrimi i popullatës, amvisërive dhe banesave në RMÇ”, 2002, Libri 13

<sup>19</sup> Ibid., Libri 13

Më 4 qershor 1994 në Tetovë u mbajt Kuvendi i intelektualëve të rangut universitar nga Maqedonia ku u mor vendim për themelimin e Universitetit në gjuhën shqipe në Maqedoni, me seli në Tetovë. U zgjodh Kryesia për themelimin e Universitetit në përbërje prej tre anëtarëve (dr. Fadil Sulejmani, dr. Agni Dika, dhe dr. Murtezan Ismaili).<sup>20</sup>

Ky Këshill, pasi bëri para projektin dhe përgatitjet e tjera të nevojshme, thirri Kuvendin e Intelektualëve Shqiptarë të rangut universitar në Maqedoni, i cili u mbajt në Tetovë më 4 qershor 1994. Nga iniciativat e intelektualëve ishin krijuar edhe organe joformale, si: Kuvendi i intelektualëve dhe Kryesia për themelimin e Universitetit të Tetovës.

Diskutimet kishin të bëjnë me pyetjen se a thua ky Kuvend ka ingerenca të atilla që të mund të themelojë universitetin në gjuhën shqipe në Maqedoni? Ishte vlerësuar që aktivitetet duhet të kenë bazë ligjore, ndërsa kërkoheshin rrugët legale për themelimin e Universitetit. Në këtë kuvend ishte konstatuar se një vendim për themelimin e Universitetit duhej marrë nga kuvendi komunal në Tetovë, Gostivar, Dibër, procedurë kjo që është zbatuar edhe në themelimin e Universitetit të Manastirit, kur vendimin për themelimin e tij e kanë marrë kuvendet komunale të Manastirit, Prilepit dhe Titov-Velesit.<sup>21</sup>

Kuvendi i intelektualëve kishte aprovuar deklaratë, në të cilën ndër të tjerat thuhet: ”Kuvendi i intelektualëve shqiptarë, mori vendim për themelimin e Universitetit në gjuhën shqipe në Maqedoni. Nga rrethanat e krijuara në Maqedoni pas shpërbërjes së Jugosllavisë, kur u vunë kufijtë e paligjshëm brenda territoreve tona etnike dhe u bë i pamundur studimi i shqiptarëve nga Maqedonia në Universitetin e Prishtinës, e më gjerë, si dhe të bojkotuar nga universitetet e Maqedonisë, që i financojnë edhe shqiptarët, intelektualët shqiptarë të rangut universitar nga Maqedonia e panë të arsyeshme që të mbajnë Kuvendin për ngritjen e iniciativës për themelimin e universitetit shqip në Maqedoni.

Nga fakti se në këtë Republikë mijëra shqiptarë me shkollë të mesme e kanë të pamundshme t’i vazhdojnë studimet universitare, është nevojë e zhvillimit të natyrshëm e civilizues, marrje e këtij vendimi historik e human për ngritjen e kuadrove arsimore e shkencore të shqiptarëve në Maqedoni në gjuhën e tyre amtare.

U zgjodh njëkohësisht Këshilli themelues (amë) në përbërje prej 18 anëtarëve, ndërsa Universiteti fillon punën në vitin 1994-1995. Selia e universitetit do të jetë qyteti i Tetovës. Kërkohet nga kuvendet komunale të Tetovës, Gostivarit dhe Dibrës si dhe nga përfaqësuesit tanë politikë në Parlamentin dhe Qeverinë e Maqedonisë, të marrin përsipër sjelljen e aktvendimit për themelimin e Universitetit në gjuhën shqipe – thuhet në Deklaratë”.<sup>22</sup>

Në aktin e themelimit morën pjesë edhe kryetarët dhe nënkryetarët e Kuvendeve komunale të Tetovës, të Gostivarit e të Dibrës.<sup>23</sup>

---

<sup>20</sup>Rilindja 5 qershor 2004 f.3

<sup>21</sup>Elaborati i UT-së me rastin e themelimit, f. 2

<sup>22</sup>Elaborati i UT-së me rastin e themelimit, f.3

<sup>23</sup>Në këtë Kuvend morën pjesë dhe nënshkruan Deklaratën 116 delegatë si përfaqësues nga të gjitha trojet etnike shqiptare në Maqedoni. Pati aty dhe përfaqësues partish politike dhe asociacionesh të ndryshme shoqërore, kulturore, konfesionale dhe humanitare shqiptare në Maqedoni. Gjithashtu në Kuvend ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e Bashkësisë islame të Shkupit e të Tetovës, kryetarët dhe nënkryetarët e Kuvendeve komunale të



Ky Kuvend, pas debatit të 35 diskutuesve, miratoi njëzëri iniciativën e Këshillit nismëtar për themelimin e Universitetit shqip dhe propozimi për fillim hapjen e shtatë fakulteteve të mundshme: Fakulteti Filologjik, Fakulteti Filozofik, Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore, Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti Teologjik – Dega Islame dhe Fakulteti i Arteve.

Kuvendi zgjodhi njëkohësisht edhe organet e përkohshme për themelimin e Universitetit, si: Kryesinë e Universitetit prej tre anëtarësh dhe Komisionet për hapjen e Fakulteteve të lartpërmendura, që do ta përgatitnin elaboratin, Plan programet dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm për themelimin dhe funksionimin e këtij Universiteti, përkatësisht për hapjen e këtyre fakulteteve.

Zhvillimi i situatës rreth zyrtarizimit të Universitetit është shoqëruar me ngjarje të llojllojshme, ku drejtpërdrejtë ka qenë kyçur përveç faktorit intelektual edhe ai politik.<sup>24</sup>

---

Tetovës, të Gostivarit e të Dibrës; një numër këshilltarësh të kuvendeve komunale shqiptare në Maqedoni, si dhe disa deputetë dhe politikanë zyrtarë shqiptarë në Qeveri.

<sup>24</sup>Renditja kronologjike e datave rreth zhvillimeve në UT

14.maj, 1994: Intelektualë shqiptarë mbajnë mbledhjen e parë të Këshillit Nismëtar për themelimin e një Universiteti në Maqedoninë perëndimore.

4 qershor, 1994: Në Tetovë mbledhet Kuvendi i Intelektualëve Shqiptarë kryesisht të rangut universitar: zgjidhet Këshilli për themelimin e Universitetit, i cili u quajt sipas selisë – Universiteti i Tetovës. Po ashtu merret vendim që të hapen shtatë fakultete;

25 tetor, 1994: Kërkohej nga Qeveria të miratojë hapjen e Universitetit;

14 dhejtor, 1994: Policia ndërhyrë për të penguar përgatitjet për fillimin e punës së Universitetit. Në Reçicë të Vogël shembet një pjesë e objektit të meremetuar për nevojat e tij;

17 dhjetor, 1994: Në Tetovë nënshkruhet Akti për Themelimin e Universitetit të Tetovës nga anëtarë të Këshillit, kryetarëve të komunës së Tetovës, Gostivarit e Dibrës. Gjashtë ditë më vonë shpallet konkursi për pranimin e studentëve;

12-13 shkurt, 1995: Regjistrohen kandidatët e pranuar.

15 shkurt, 1995: Në Reçicë të Vogël solemnisht shpallet i hapur Universiteti i Tetovës;

16-17 shkurt, 1995: Në Poroj fillojnë ligjëratat e para. Në Reçicë të Vogël ndërhyrje e policisë. Vritet Abdilselam Emini nga fshati Lisec i Tetovës.

Për implikim në këto zhvillime lidhur me UT-në (e jashtëligjshëm e kundërkushtetues për qeverinë maqedonase), me dënim prej disa muajsh e deri në 2.6 vjet u dënuan rektori Fadil Sulejmani, Milaim Fejziu, Nevzat Halili, mr. Musli Halimi;

Ndërsa, gjatë gjithë kësaj kohe PPDSh-ja dhe PDP-ja ishin në mbështetje të fortë të UT-së.

Korrik, 2000: Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me shumicë votash miratoi Ligjin mbi Shkollimin e lartë. Deputetët e PPD-së, tani në opozitë bojkotojnë diskutimin. Me të parashikohet edhe themelimi i universiteteve private. UT-ja, kësaj rradhe e mbështetur nga PPD-ja kundërshton këtë duke kërkuar zyrtarizimin dhe financimin e universitetit nga ana e shtetit.

Nëntor – Dhjetor, 2000: Qeveria mbështet projektin e Komisionerit të Lartë të OSBE-së për minoritetet për një institucion të ri privat të shkollimit të lartë. Mendohet se ai ka për të zëvendësuar UT-në. Në të njëjtin vit lëshohet në përdorim objekti i ndërtuar disa katësh me finansimin e mërgimtarëve i cili ndryshe u quajt si objekti historik.

Shkurt, 2001: Në Tetovë paralajmërohet fillim i ndërtimit të Universitetit të Ri, zyrtarisht të emërtuar si Universiteti i Evropës Juglindore.<sup>24</sup>

## 2.3. Rasti ” Universiteti i Evropës Juglindore” ( UEJL-së)

Në pranverë të vitit 2000 Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare inicioi diskutimet për themelimin e një Universiteti të ri në Republikën e Maqedonisë, e cila u mbështet nga donatorët ndërkombëtarë.

Universiteti i Evropës Juglindore zyrtarizoi fillimin e punës së vet më 20 nëntor të vitit 2001, ndonëse historia e tij, daton nga më herët, pra, nga atëherë kur komisionari i lartë i OSBE-së, shkëlqesia e tij, Max Van der Stoel, dha propozimin që edhe gjuha shqipe të përdoret në arsimin e lartë, në Republikën e Maqedonisë, në kuadër të institucioneve arsimore “private”. Kështu, në fillim të vitit 2000, së bashku me ekspertë të tjerë nga Këshilli i Evropës, z. Stoel, realizoi edhe takimin e parë me autoritetet e Maqedonisë dhe shpалosi idenë për një institucion të arsimit të lartë, të bazuar në kriteret ndërkombëtare, që më pas t’u bëjë thirrje ekspertëve ndërkombëtarë për përgatitjen e një plani deskriptiv, të bazuar në një plan financiar, për themelimin e një Universiteti. Ky Universitet do të jetësohet, në përputhje me standardet e pranuar dhe të njohura për arsimin e lartë në Evropë.

Pas miratimit të Ligjit mbi Arsimin e Lartë nga ana e Parlamentit të Maqedonisë me 03 gusht 2000-“ Gazeta zyrtare e RM –së” Nr. 64/2000, neni 2 pika 22 e cila thot se „themelues i Universitetit mund të jetë Parlamenti i RM-së, si dhe personi fizik dhe juridik i vendit dhe i jashtëm i cili mund të jetë themelues i institucionit të arsimit të lartë bazuar në këtë ligj. Ky Ligj lejoi krijimin e universiteteve private të cilat nuk janë të lidhura me shtetin, me një fjalë kjo ishte mundësia e vetme për arsimimin e rinisë shqiptare në gjuhën shqipe por në institucion privat.

Ishte kjo një kohë kur në UT tani më kishin filluar të dalin edhe të diplomuarit e parë, por shteti gjithë këtë e bëri me qëllim që t’ua ndalojë shqiptarëve arsimimin në gjuhën shqipe në Universitet Shtetëror. Në fund të vitit 2000, Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare i OSBE-së Max Van der Stoel filloi planifikimin për ngritjen e Universitetit.<sup>25</sup>

UEJL konsiderohet si një model ku zhvillohet arsimimi i të gjitha nacionaliteteve, pra mund të konsiderohet si institucion multietnik dhe shumë-gjuhësor i arsimit të lartë në Evropën Juglindore. Për më tepër, ai ka arritur një përvojë shumë të mirë në kombinimin e Evropës dhe të SHBA, dhe ka vazhduar për të përfituar nga bashkëpunimi i përvojave akademike të sponsorizuar nga Komisioni i BE-së dhe të USAID-i, në mesin e donatorëve të tjerë. Sipas Ligjit të arsimit të lartë të Republikës së Maqedonisë, kushti minimal për themelimin e një institucioni të arsimit të lartë, me karakter privat ishte, që vetë institucioni të ketë pesë fakultete dhe dy shkolla të larta. Që atëherë, insistimi i faktorëve vendorë ishte, që Universiteti i ri të ketë më shumë programe mësimore dhe nga më shumë fusha, gjithnjë me të vetmin qëllim për të plotësuar nevojat për arsimim të lartë, veçanërisht të shqiptarëve, pasi pragu i pranimit, të tyre në institucionet e akredituara arsimore ishte shumë i ulët. Fondacioni ndërkombëtar, përkatësisht Bordi i tij, në Zvicër, themeloi edhe Fondacionin lokal dhe, në këtë mënyrë, në fillim të vitit 2001, ekspertët lokalë dhe ata ndërkombëtarë u përqendruan në përgatitjen e detajeve të plan-

---

<sup>25</sup>Puna për ndërtimin e tij filloi në mars të vitit 2001, dhe Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL) u hap gjashtë muaj më vonë. Në nëntor të vitit 2002, numri i studentëve ishte 2250, dhe në tetor 2003, numri kishte arritur në 3.700.

programeve studimore (kurikulumeve), si dhe të projektit të përgjithshëm, hap ky i nevojshëm për procedurën e akreditimit.

UEJL ishte institucioni i parë në Maqedoni dhe në rajon, që tërësisht u organizua sipas Deklaratës së Bolonjës, me studime në cikle.

Standardet e harmonizuara dhe vlerësimi i dijes evropiane me nevojat dhe kërkesat e kohës është një provë e suksesshme për UEJL, prandaj, ajo që konsiderohet një detyrim i madh është që të vazhdojë të jetë një udhëheqës i standardeve arsimore dhe vlerat akademike në rajon.

## **2.4.Themelimi dhe funksionimi i “Universitetit të Tetovës “(nga UT -USHT)**

Periodha e dytë në zhvillimin e aktiviteteve rreth zyrtarizimit të arsimit sipëror në gjuhën shqipe është zyrtarizimi i punës dhjetëvjeçare të funksionimit të këtij universiteti-UT, kur më 22.02.2004 Qeveria e R. së Maqedonisë mori vendim që ta njohë këtë universitet. Miratimi i Ligjit për themelimin e Universitetit Shtetëror në Tetovë ka krijuar bazë normative dhe ligjore për qasje më të madhe në arsimin e lartë nga bashkësitë pakicë, si që janë shqiptarët dhe bashkësitë tjera.<sup>26</sup>

Vlen të potencohet gjithashtu, se Qeveria e Maqedonisë në bazë të ligjit për arsim të Shpallur në “Gazetën zyrtare të RM-së”, nr.8, faqe 5, 23 shkurt 2004, Shkup Ligjit për themelimin e USHT-së, neni 4, USHT i ndau 5 (pesë) hektarë tokë për ndërtimin e godinave universitare<sup>27</sup> prandaj, organet udhëheqëse universitare bashkë me Qeverinë dhe Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës së R. së Maqedonisë bëjnë përpjekje maksimale që të fillojnë të dizajnon ndërtimin e Kompleksit Universitar me të gjitha objektet tjera përcjellëse, sepse USHT kërkon t’i plotësojë standardet sipas Ligjit dhe normativit të arsimit të lartë në R. e Maqedonisë dhe kriteret akademike bashkëkohore dhe evropiane.

Ky moment padyshim konsiderohet si akt tjetër historik shumë domethënës për këtë institucion, sepse R. e Maqedonisë fitoi edhe një institucion të arsimit të lartë dhe me këtë akt, u bë një shtytje përpara drejt proceseve demokratike dhe ngritjen e nivelit dhe të vetëdijes të të gjithë qytetarëve drejt integritimit në familjen e vendeve evropiane.

Periodha e tretë, padyshim është periodha e akreditimit të USHT-së, sepse me akreditimin Universiteti rumbullakësoi dhe përmbushi kornizën ligjore e akademike të funksionimit dhe strukturimin e gjithmbarshëm.<sup>28</sup>

---

<sup>26</sup>Ligji për themelimin e Universitetit shtetëror në Tetovë, citat i hapur, nr. 08/2004

<sup>27</sup>Shpallur në “Gazetën zyrtare të RM-së”, nr.8, faqe 5, 23 shkurt 2004, Shkup Ligjit për themelimin e USHT-së, neni 1.

<sup>28</sup>Universiteti Shtetëror i Tetovës është i strukturuar në pesë njësi përbërëse dhe atë, në: FSHMN me katër programe studimore, FSHHA me dymbëdhjetë programe studimore, Fakultetin Juridik, Fakultetin Ekonomik dhe Qendrën për Studime Politeknike me dy drejtime; Shpallur në “Gazetën zyrtare të RM-së”, nr.8, faqe 5, 23 shkurt 2004, Shkup Ligjit për themelimin e USHT-së, neni 1.

Objektivi, misioni dhe vizioni i zhvillimit dhe dimensionimit të USHT-së konsiston në avancimin dhe rritjen e cilësisë në procesin e mësimdhënies bashkëkohore dhe dijes, avancimin shkencor dhe kadrovik, atë materialo-teknik, hapësinor dhe infrastrukturual.

Gjatë funksionimit dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të Universitetit Shtetëror të Tetovës është paraparë Strategjia e operacionalizimit, dimensionimit dhe e zhvillimit të Universitetit.

a) Strategjia e operacionalizimit të USHT-së; - nënkupton efikasitetin dhe azhuritetin e funksionimit të universitetit për studentët, stafin akademik, administratën dhe të gjithë të punësuarve të tjerë;

b) Strategjia e dimensionimit të USHT-së; - nënkupton plotësimin e të gjitha kushteve për funksionim normal, si në aspektin kuadrore, hapësinor, materialo-teknik dhe administrative;

c) Strategjia zhvillimore e USHT-së;-do të jetë strategji e avancimit të universitetit drejt përpjekjeve maksimale që të risë cilësinë akademike, duke u bazuar në standardet evropiane të shkollimit të lartë sipas Magna Kartës, marrëveshjes së Bolonjës, Konferencës së Glazgout, Konferencës së Bergenit, Konferencës Ballkanike të Tiranës dhe shumë e shumë takimeve tjera që çojnë drejt avancimit të modelit të reformuar të arsimit të lartë sipas sistemit të transferit të kredive apo ECTS, sistemit dhe implementimit sa më të shpejtë të këtyre standardeve evropiane në USHT.

Me këtë Strategji i jepet impuls edhe më i madh Universiteti Shtetëror të Tetovës që sa më shpejt t'i implementojmë këto trende të shkollimit të lartë për të përmbushur ato standarde që i kërkon arsimit sipëror bashkëkohor evropian dhe botëror.

Sa i përket bashkëpunimit ndëruniversitar, ka bashkëpunim me universitetet ekzistuese në R. e Maqedonisë veçanërisht potencohet bashkëpunimi ndëruniversitar me universitet rajonale.

Universiteti Shtetëror i Tetovës gjatë vitit kalendarik 2008 konkretisht me 27 shtator të 2008 (në shënimin e 920 vjetorit të Universitetit më të vjetër në Evropë, Universiteti i Bolonjës dhe 20 vjetorit të dokumentit inicues dhe më të rëndësishëm të Procesit të Bolonjës: MagnaChartaUniversitatum), krahas 45 universiteteve të tjera nga të gjitha kontinentet, nënshkroi Deklaratën e Bolonjës. Rektori i atëhershëm i USHT prof. Dr. Sadi Bexheti në një ceremoni tradicionale në Universitetin e Bolonjës, në prani të mbi 100 rektorëve nga e gjithë bota, nënshkroi MagnaChartaUniversitum, dokumentin që i paraprinë Deklaratës së Bolonjës së datës 19 qershor 1999, e që synon krijimin e një hapësire të përbashkët Evropiane të arsimit të lartë, duke marrë kështu për obligim që të inkurajojë secilin shtet, si dhe organizatat mbi nacionale relevante që të sajojnë me vendosmëri politikat e tyre në pajtim me këtë përmbledhje parimesh.<sup>29</sup> USHT duke respektuar premisat që dalin nga këto dokumente si dhe nga Ligji për arsim të lartë në RM, ka konsoliduar të gjitha kurikulat e programeve studimore, duke vendosur sistemin 3+2+3, ka bërë vendosjen e standardeve të performancës, menaxhimin e kualitetit si dhe Sistemin ECTS si një ndër kërkesat themelore të ristrukturimit të arsimit të lartë, që parashtrohet në deklaratën e Bolonjës, parimet e së cilës i ka pranuar dhe po punon për t'i realizuar. Padyshim, kjo është një e arritur e madhe e USHT-së ngase edhe ky institucion u fut në familjen e universiteteve evropiane.

Në Universitet, është aprovuar sistemi ECTS i kreditimit, i cili rekomandohet edhe me Deklaratën e Bolonjës. Sistemi ECTS momentalisht përdoret për akumulimin e kredive dhe parashihet që të përdoret edhe si mjet që mundëson transferin e kredive në nga universitet tjera evropiane.<sup>30</sup>

<sup>29</sup>[www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), 27 shtator, arhiva

<sup>30</sup>Informatori I USHT-së ,viti II. Nr.2, korrik 2006 faq-10

Nëse e bëjmë një krahasim me dhjetëvjetëshim e fundit të shekullit XX-të shihet qart se sjellja e ligjit për zyrтарimin e UT-së ka sjellë ndryshime të jashëzakonshme pozitive. Të dhënat krahasuese të Ministrisë për arsim dhe shkencë tregojnë rritje dhe përmirësim në pjesëmarrjen e bashkësisë shqiptare në arsimin e lartë gjatë 12 viteve të fundit. Në vitin 1992/93, prej gjithsej 26,299 studentëve në Maqedoni, shqiptarët janë përfaqësuar me 2.23% nga totali i regjistrimeve në universitete. Kjo dallon shumë me gjendjen e vitit 2004/2005, ku prej 61,556 studentëve, shqiptarët përfaqësohen me 15.50% nga totali i numrit të studentëve.<sup>31</sup> Kjo rritje e pjesëmarrjes së studentëve të bashkësisë shqiptare mund t'i përshkruhet rritjes së numrit të universiteteve shtetërore dhe private. Këtu mund të ceket UEJL në Tetovë dhe Universiteti shtetëror në Tetovë, ku ofrohet ligjërim në gjuhën shqipe. Zhvillimet e fundit me hapjen e universiteteve private dhe rritjen e konkurrencës në këto institucione kanë krijuar mundësi për interaksion më të madh mes bashkësive në nivel universitar.

## **2.5. Sfidat me të cilat ballafaqohet arsimit sipëror në RM**

Pikësnyimi në këtë hulumtim ka qenë të hulumtojmë funksionimin e Arsimit Sipëror në RM, duke filluar me hapjen e Universitetit Shën Kirili dhe Metodi në Shkup, për të vazhduar më pas me problemet të cilat u ballafaquan të rinjtë shqiptar në Maqedoninë Socialiste e deri në vitet e 90-ta kur nga iniciativa qytetare në Vitin 1994 u themelua UT-ja, i cili zgjodhi një problem të rinjve edhe pse u dashtë që të pritet 10 vjet për t'u zyrтарizuar, por ky qe shtegu i vetëm ku të rinjtëmë në fund e sfiduan këtë katrahurë dhe gjetën rrugën e studimit.

Fatkeqësisht, Maqedonia edhe pse prej shpalljes së saj si shtet i pavarur në vitin 1991 është pranuar si anëtare e OKB-së dhe njëherit ka qenë nënshkruese e kësaj konvente, por ajo fatkeqësisht nuk e ka zbatuar këtë konventë në praktikë. Mund të themi se ajo ka filluar me zbatimin e saj në vitin 2000 kur solli vendimin për themelimin e universiteteve private, ku do të kishin mundësi shqiptarët të ndjekin mësimin në gjuhën shqipe (themelimi i UEJL-së, dhe më vonë në vitin 2004 kur solli Ligjin për zyrтарizimin e Universitetit të Tetovës).

Mendojë se Arsimit duhet të jetë i kapshëm për të gjithë, veçanërisht për grupet e rrezikuara dhe të pafavorizuara, dhe atë: pa bërë dallim në fe, racë, komb apo nacionalitet, pa përjashtim se në cilin shtet jeton personi.

Në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë do të jetë e regjistruar në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s (neni 19).

Në pjesën e dytë “SFIDAT E ARSIMIT SIPËROR NË GJUHËN SHQIPE NË MAQEDONI.” jamë përqëndruar kryekëput në zhvillimin e arsimit sipëror në RM duke filluar nga hapja e Universiteteve në Maqedoni pas Luftës së dytë Botërore, mungesën e përfshirjes së kuadrit dhe studentëve shqiptar nëpër këto institucione e deri në mbylljen e atyre pak drejtimeve të cilat funksionuan në gjuhën shqipe në kuadër të Universiteteve maqedone.

Pasi kaluan dy dekada e gjysmë nga themelimi i Universitetit të Shkupit, në vitin 1971-72 u themelua grupi i gjuhës dhe letërsisë shqipe, por në kuadër të degës së gjuhëve jugosllave e ballkanike deri në vitin 1973, kur ajo u mëvetësua si degë e veçantë.

Fatkeqësisht kjo përjetëz zgjati shumë pak me që edhe pse pas kalimit të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Akademi Pedagogjike u hapën disa drejtime të reja në gjuhën shqipe, por kjo fatkeqësisht zgjati shumë pak. Pasi pas demonstratave të vitit 1981 në Prishtinë dhe mbarë

---

<sup>31</sup>Ministria e arsimit dhe shkencës e Republikës së Maqedonisë, "Studentët e regjistruar në studimet diplomike dhe pasdiplomike, qytetarë të Maqedonisë sipas përkatësisë etnike 1992/1993 – 2004/2005".

Kosovën dalë ngadal do të fillojë heshturazi mbyllja e të gjitha drejtimeve ku mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe. Fillimisht u fillua me diferencimin e kuadrit mësimor, pastaj me ndrimin e administratës për të artitur në fund të viteve të 80-ta edhe deri tek mbyllja e pothuajse të gjitha drejtimeve të mësuesisë përpos katedrës së gjuhës shqipe ku vetëm disa lëndë zhvilloheshin në gjuhën e “nacionaliteteve” dhe drejtimit të grupit klasor në gjuhën shqipe ku mësimi zhvillohej në kuadër të Akademisë Pedagogjike.

Duke filluar nga viti akademik 1983-84 në mënyrë sukcesive u suprimuan grupet dhe përfundimisht më 08.10.1987 u ndërpre mësimi në gjuhën shqipe në Akademi.

Gjatë punës intelektuale 30 vjeçare (1946-1976) të Universitetit, në gjashtë degë të Fakultetit Filologjik dhe në pesë degë të Fakultetit Filozofik, nga gjithsej 5375 studentë të diplomuar, vetëm 92 nga to janë të përkatësisë shqiptare, ose shprehur në numër relativ, në 11 degë të këtyre dy fakulteteve nga numri i përgjithshëm u diplomuan vetëm 1,71 % studentë shqiptarë. Ose gjithsej studentë të diplomuar në dy fakultetet dhe në AP janë 12.566 nga të cilët vetëm 1122 janë shqiptarë ose 8.92 %.

A thua vallë nuk është diskriminim për shqiptarët e Maqedonisë? Dhe a thua vallë nuk duhej që të hulumtohej ky holokaust që po ndodhte me shqiptarët e Maqedonisë kur fatkeqësisht arsimtarëve nëpër shkollat fillore dhe të mesme gjatë ligjërimit i'u ndërpre e drejta që disa emra të qyteteve të Maqedonisë para nxënësve të tyre t'i thirnin në gjuhën shqipe siç ishte p.sh.për Shkupin –Skopje, për Manastirin Bitolla e kështu me radhë e jo më të studjonin në gjuhën shqipe.

Iniciativa qytetare ndikoi edhe në ndryshimin e ligjit për arsim nga ana e Parlamentit të RM, që popujt pakicë të kenë të drejtën e hapjes së Universiteteve Private, gjë që solli hapjen e Univeritetit të Evropës Juglindore, e ku përfshihet sjellja e ligjit për hapjen e Universiteteve në gjuhën shqipe, kryesisht themelimin e UT-së- Universitetit të Tetovës të cilat njëherë janë edhe anëtare të Procesit të Bolonjës.

Nga ai diskriminim që përmendëm më lart u desht që nga iniciativa qytetare të lind një Univerisitet që do të plotësonte nevojat e shqiptarëve për studim në gjuhën shqipe. Ajo ndodhi më 4 qershor 1994 kur në Tetovë u mbajt Kuvendi i intelektualëve të rangut universitar nga Maqedonia ku u mor vendim për themelimin e Universitetit në gjuhën shqipe në Maqedoni, me seli në Tetovë, i cili funksiononte jashta sistemit deri në vitin 2004. Fatmirësisht duke i'u falemenduar këmbëngulësisë së intelektualëve kuadrit mësimor, studentëve dhe faktorit politik shqiptar në Maqedoni, shekulli XXI i gjeti shqiptarët e Maqedonisë me dy institucione të larta arsimore në gjuhën shqipe njëri privat e tjetri shtetëror. Nëse do të shohim statistika do të vërejmë një dallim të dukshëm Në vitin 1992/93, prej gjithsej 26,299 studentëve në Maqedoni, shqiptarët janë përfaqësuar me 2.23% nga totali i regjistrimeve në universitete. Kjo dallon shumë me gjendjen e vitit 2004/2005, ku prej 61,556 studentëve, shqiptarët përfaqësohen me 15.50% nga totali i numrit të studentëve. E të mos flasim kohëve të fundit ku pothuajse 50 përqind e maturantëve vazhdojnë studimet.

### **Rekomandime:**

- Të ridefinohet funksioni i Byrosë për shvillimin e arsimit dhe përkufizimi i tyre në lidhje me themelimin e institucionit relativisht të pavarur për ndërtimin e standardeve për përkrahjen dhe zhvillimin profesional të arsimtarëve dhe të shërbimeve profesionale në shkollat;
- Ministria e arsimit të zhvillojë kriter sipas të cilit do të përcaktohen kualifikimet për rektor;
- Ky kriter duhet të jetë objektiv;
- Anëtarësia/lidhja me parti politike nuk duhet të merret parasysh si kriter për

zgjedhjen;

- Ministria e arsimit të jetë transparente në procedurat për zgjedhje të punësimeve të reja, në përparimin e të punësuarve në vendet e punës si dhe për largimin e tyre nga puna;
- Të përforcohet Inspektorati Shtetëror i arsimit;
- Të themelohet Qendër shtetërore për kërkime;
- Univerzitetet në Republikën e Maqedonisë duhet të bartin përgjegjësi për zhvillimin dhe udhëheqjen e stërvitjeve për drejtorë.

### **Literatura:**

1. 60 vite Shkollë e Lartë Pedagogjike”, Akademi P. Fakultet P-(1947-2007), Shkup 2007
2. Rruga e zhvillimit dhe perspektiva e saj”, (botimi jubilar në dy gjuhë paralele e Akademisë Pedagogjike “Kliment Ohridski”)– Shkup, 1977.
3. Shkolla e Lartë Pedagogjike, Akademi Pedagogjike, Fakultet Pedagogjik (1947-1961-1996-2007), Shkup 2007 Universiteti “Sh. Kirili dhe Metodi” Fakulteti Pedagogjik “Sh.Kliment Ohridski” – Shkup, “60 Vite”,
4. XhonDjui, Obrazovanie i demokratija (përkthim), Cetinje 1966, TahirZajazi (Themelimi dhe zhvillimi i Akademisë Pedagogjike “Klementi i Ohrit” në Shkup)
5. Abazi, dr. Nexhat, “Zhvillimi i arsimit, i shkollave dhe i mendimit pedagogjik shqiptar në Maqedoni” (1830-1912), Tetovë, 1997.
6. ZajaziT. Jehona, nr.1-2/1999.
7. Veseli, dr. Abdylazis, ”Shkollat dhe arsimi shqip në Maqedoni gjatë periudhës 1941 – 1944”, Tetovë: Çabej, 2000.
8. Shqipëtarët e Maqedonisë (material i simpoziumit) Shkup 1994.
9. Wajdenfeld Werner, Wessels Wolfgang, ”Evropa Von A bis Z”, Twins, Pringing Studio and Graphic Enterprise, Bon 2002.
19. Gazeta ”Rilindja”, Prishtinë, 27 qershor 1998, fq.6.
20. Gazeta ”Flaka” –Shkup 6 qershor 1994, fq 3.
21. Elaborati i UT-së me rastin e themelimit.
22. Revista ”Lobi”-nr-1, janar 2001.
23. Informatori i USHT-së viti II. Nr.01, korrik 2006.
24. Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë (2006) *Raporti vjetor*, [www.zvrm.gov.mk](http://www.zvrm.gov.mk)

25. Enti shtetëror statistikor,” Regjistrimi i popullatës, amvisërive dhe banesave në RMÇ”,2002, Libri 13, 11 Ibid., Libri 13
26. Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 51/2007 dhe 49/2007.
27. Ministria e arsimit dhe shkencës (2006) Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015 me dokumentet shoqëruese programore (në maqedonisht), Shkup: Ministria e arsimit dhe shkencës.